

EMA KRISTO

**REALIZIMI GJUHËSOR I KRITIKËS NË RECENSIONET
SHKENCORE. VËSHTRIM KRAHASUES NË GJUHËN SHQIPE
DHE GJERMANE**

Ky artikull paraqet një analizë kontrastive të recensioneve shkencore në gjuhën shqipe dhe gjermane. Recensionet jo vetëm informojnë mbi një publikim të caktuar, ato japin edhe vlerësime objektive. Kultura të ndryshme luajnë një rol të rëndësishëm në motivet për shkrimin e një recensionit. Analiza e detajuar e korpusit të hartuar tregon se segmente të caktuara tekstore të recensioneve shkencore në gjuhën gjermane dhe shqipe realizohen në mënyra të ndryshme.

Fjalë kyç: recension shkencor, vlerësim pozitiv, vlerësim negative, segmente tekstesh.

1. Recensionit shkencor

Recensionit shkencor ka fituar rëndësi kohët e fundit në fushën e komunikimit shkencor edhe në Shqipëri. Me anë të recensioneve të punimeve shkencore ne informohemi në lidhje me botimet e reja në disiplina të ndryshme shkencore si dhe përfitojmë një tablo të përgjithshme mbi tendencat e reja të punimeve shkencore. Recensuesi – siç dihet eksperti i një fushe të caktuar – merr përsipër detyrën që të përmbledhë dhe të vlerësojë përmbajtjet më të rëndësishme të punimit të recensuar.

Në përgjithësi në një recensim shkencor bëhet fjalë për një proces filtrimi, pasi recensuesi duhet t'i prezantojë lexuesit informacione mbi veprën e publikuar në mënyrë selektive.¹ Gjatë recensimit realizohen dy funksione themelore: nga njëra anë recensuesi *informon* mbi përmbajtjen e publikimit dhe nga ana tjetër ai e *vlerëson* këtë përmbajtje. Si në gjuhën gjermane ashtu edhe në atë shqipe recensionit shihet si një diskutim kritik i një botimi shkencor.

Recension = Vlerësim kritik me shkrim për një vepër artistike, për një punim shkencor për një shfaqje etj., duke dhënë përmbajtjen dhe duke vënë në dukje anët e mira dhe të metat.²

¹ Hutz, 2001, f. 110.

² *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë 1984. Akademia e shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i letërsisë. Kolona 1012.

“Rezension = kritische Besprechung eines Buches, einer wissenschaftlichen Veröffentlichung, künstlerischen Darbietung, in der man den Inhalt wiedergibt und die positiven und negativen Aspekte darstellt.”

Përkufizimi pothuajse identik në të dyja gjuhët na jep shumë pak të dhëna në lidhje me të përbashkëtat dhe ndryshimet e mundshme midis recensioneve në gjuhën shqipe dhe atë gjermane në aspektin komunikativ, funksional dhe gjuhësor. Prandaj në vazhdim të këtij artikulli do të diskutohen dy çështje:

- A ndryshojnë nga ana specifike recensionet shqiptare dhe ato gjermane pavarësisht funksioneve të përbashkëta themelore *dhe*

A realizohet kritika në diskutet shkencore në të dyja kulturat në mënyra të ndryshme?

1.1 Arsyet për shkrimin e recensioneve shkencore

Duke u nisur nga pikëpamja komunikative-pragmatike arrijmë në përfundimin se hartimi i recensioneve shkencore është i lidhur ngushtë me qëllimin që ato realizojnë. Pa iu referuar një kulture të caktuar, Wiegand³ përmend një mori arsyesh për shkrimin e recensioneve shkencore:

1. arsye ekonomike: R (R=recensuesi) recenson A (A=punimi), në mënyrë që A të publikohet pa pagesë.

2. arsye shkencore: R recenson A, që është shkruar/publikuar nga Sh1 (Sh=shkencëtar), në mënyrë që të dëmtojë ose të ndihmojë Sh2

3. arsye që kanë të bëjnë me shtëpinë botuese: R recenson një punim A në mënyrë që t'i vijë në dobi ose të dëmtojë një shtëpi botuese

4. arsye objektive shkencore: R recenson A, në mënyrë që të prezantojë në mënyrën e duhur veprën dhe vlerën e saj; R recenson A në mënyrë që ajo të bëhet e njohur në rrethet shkencore; R recenson A në mënyrë që të lindë një diskutim shkencor rreth veprës.

5. arsye që i referohen veprës së recensuar: R recenson A në mënyrë që të godasë personalisht hartuesin e veprës A, ta dëmtojë ose ta ndihmojë atë.

Natyrisht që këto arsye variojnë nga recensionit në recension. Pra ekziston një shumëllojshmëri arsyesh individuale që e nxisin një recensues të recensojë një vepër shkencore.

Liang⁴ përmend faktin se në radhë të parë recensionet duhen shkruar për arsye objektive shkencore. Të paktën në Gjermani kjo ndodh rëndom.

2 Analizë kontrastive gjermanisht/shqip

2.1 Zgjedhja e korpusit

Korpusi me tekste, mbi të cilin mbështetet ky punim përfshin 90 recensione: 45 në gjuhën shqipe dhe 45 në gjuhën gjermane nga revista shkencore në fushën e mësimdhënies së gjuhës gjermane dhe linguistikës.

³ Wiegand, 1983, f. 125.

⁴ Liang, 1991, f. 29.

Natyrisht që me këtë korpus nuk mund të pretendohet se arrihet në përfundime përgjithësuese, gjithsesi mund të hidhen disa hipoteza të cilat mund të verifikohen me anë të studimeve empirike më të gjera se ky korpus.

Duke përdorur shembuj konkretë, janë bërë përpjekje të analizohen në mënyrë kontrastive në tekstin në vijim struktura tekstore e recensioneve shkencore në të dyja gjuhët, si dhe përcaktimi socialkulturore i tyre duke vënë në pah ngjashmëritë dhe dallimet e mundshme.

2.2 Analiza

Për të vënë në pah tiparet specifike të recensionit shkencor u analizuan karakteristikat variable dhe jo variable të këtij lloji teksti. U përcaktuan pjesët e tekstit dhe segmentet përbërëse të tekstit të cilat mund të shfaqen në recensionet shkencore.

Segmentet e tekstit janë sipas Oldenburg⁵ “njësi më të mëdha funksionale të teksteve, të cilat dallohen nga njëra-tjetra nga ana formale dhe tematike”.

Ato janë njësi autonome semantiko-pragmatike, të cilat së bashku me segmentet e tjera formojnë tekstin si një njësi të tërë. Pjesë teksti tipike të recensionit shkencor janë p.sh.: *titulli, hyrja, ndërtimi, vlerësimi*. Me anën e një analize integrative-funksionale u analizua shpeshësia e segmenteve të veçanta në këndvështrim krahasues ndërgjuhësor. Për hartimin e kësaj analize jemi mbështetur tek Hutz⁶.

2.3 Segmente tekstore të recensioneve shkencore në gjuhën shqipe dhe gjermane: Krahasime cilësore

Në vijim do të analizohen në mënyrë kontrastive recensione në gjuhën shqipe dhe gjermane. Si objekt studimi janë përzgjedhur tekste recensioneve shkencore në të dyja gjuhët. Veç të tjerash do të studiohet edhe fakti se nëse dhe deri në çfarë mase segmentet tekstore si pjesë përbërëse të recensioneve janë të ndikuara nga normat kulturore.

A *Titulli / Të dhëna bibliografike*

Përzgjedhja e titullit është një pjesë e rëndësishme e gjithë organizimit të tekstit. Titulli merr një funksion të rëndësishëm tekstual. Në recensionet në gjuhën gjermane shfaqen si titull në shumicën e rasteve të dhënat bibliografike, të cilat na informojnë mbi publikimin që po recensohet:

(1) Altmayer, Claus: Kultur als Hypertext: Zur Theorie und Praxis der Kulturwissenschaft im Fach Deutsch als Fremdsprache. München: iudicium, 2004. 511 Seiten (Dt3)

‘Altmayer, Claus: Kultura si hipertekst. Mbi teorinë dhe praktikën e shkencave kulturore në degën Gjermanishtja si Gjuhë e Huaj. Mynih: iudicium, 2004. 511 f.’

⁵ Oldenburg, 1992, f. 68.

⁶ Hutz, 2001, f. 27.

Vihen re variante të ndryshme në lidhje me pikësimin apo me renditjen e të dhënave bibliografike (Autori, titulli, data e botimit të veprës, vendi i botimit, shtëpia botuese, nr. i faqeve). Por gjithsesi funksioni i tekstit është gjithmonë i njëjti: Lexuesit informohen mbi publikimin e recensuar. Dhe tek recensionet në gjuhën shqipe konstatohet i njëjti fakt:

(2) Rexhep Ismajli “Artikuj për gjuhën shqipe” Shtëpia botuese “Rilindja”, Prishtinë, 1987, 254 f. (Alb1)

B Pjesa e tekstit: *Hyrja*

B1 Segmenti: *Informacione të përgjithshme mbi veprën e recensuar*

(3) Doris Bachmann-Medick hat der aktualisierten Neuauflage des von ihr heraus-gegebenen Sammelbandes ein programmatisches Abschlusskapitel mit dem Titel “Textualität in den Kultur- und Literaturwissenschaften: Grenzen und Herausforderungen” hinzugefügt. (Dt6)

‘Doris Bachmann-Medick i ka shtuar ribotimit të vëllimit të saj një kapitull programatik përmbledhës me titull “Tekstualiteti në shkencën e letërsisë dhe kulturës: Kufij dhe sfida”

(4) Libri i ka fillimet në një aktivitet me temë “Hyrje në shkencën e gjuhësisë” të organizuar në një seminar të gjermanistikës në Universitetin e Tiranës të mbajtur për herë të parë në vitin 2000. (Alb4)

B2 Segmenti: *Qëllimi dhe objekti*

(5) [D]er Autor [unternimmt] mit seiner vorliegenden Arbeit den Versuch, die landeskundlichen Forschungen auf eine neue wissenschaftliche Basis zu stellen, mit dem Ziel, die Landeskunde als eigenes Forschungsfach innerhalb des Deutschen als Fremdsprache zu etablieren. (Dt3)

‘Me anë të këtij botimi autori ndërmerr përpjekjen t’i vendosë në një bazë të re shkencore kërkimet mbi kulturën e një vendi, me qëllimin që të inkudrojë lëndën e Landeskunde-s si një degë kërkimi të veçantë brenda studimit të gjermanishtes si një gjuhë e huaj’

(6) Për ta çuar në fund një punë të tillë të mundimshme me fjalorin, prof. Demiraj u motivua jo vetëm nga shtypa për t’i nxitur përdoruesit e shqipes drejt njohjes më të thellë të kësaj vepre, por edhe për t’i orientuar drejt përdorimit të një gjuhe më të pastër. (Alb6)

Në segmentin B1 nuk vihen re ndryshime të mëdha midis recensioneve në gjuhën shqipe dhe atyre gjermane, ndërkohë që në segmentin B2 konstatohen ndryshime të dukshme pasi në recensionet në gjuhën shqipe vihet shpesh në pah pozicioni social apo akademik i personit vepra e të cilit recensohet:

(7) Historiani gjerman Peter Bartl ka qenë për shumë vite rresht profesor i historisë së Europës juglindore pranë Universitetit të München-it si edhe ka drejtue Institutin Shqiptar pranë atij universiteti. (Alb7)

(8) Jashar Rexhepagiqi është një ndër doktorët e parë të shkencave të fushës së pedagogjisë, për mbarë viset shqiptare me një meritë të posaçme në

përgatitjen e profesoratit të ri në fushën e pedagogjisë, me një veprimtari të pasur në hulumtime e studime të botuara në këtë fushë. (Alb11)

B3 Segmenti: *Ndërtimi*

(9) Der Inhalt ist systematisch und überschaubar, und die Konzeption ist transparent. Das Buch besteht aus "Teil A: Hintergrundwissen DaZ", "Teil B: Didaktik und Methodik im DaZ- Unterricht" sowie "Teil C: Unterrichts-materialien" und "Anhang". (Dt8)

‘Përmbajtja është sistematike dhe e qartë, konceptimi i librit është transparent. Libri përbëhet nga “Pjesa A: Njohuri të përgjithshme DaZ”, “Pjesa B: Didaktika dhe metodika në mësimin DaZ”, “Pjesa C: Materialet mësimore” si dhe “Shtojcat”

(10) Vëllimi është i ndërtuar me 7 kapituj [...] (Alb8)

Këto informacione në segmentin B3 krijojnë hyrjen (ekspozicionin). Ky segment përmbush tek recensionet në gjuhën gjermane një funksion informues. Shumë rrallë shfaqen këtu komponentë vlerësues. E kundërta konstatohet tek recensionet në gjuhën shqipe, ku vihen re rëndom elementët vlerësues:

(11) Vepra e dr. Dushan Bandiqi, docent në Fakultetin Filozofik të Beogradit, meriton të prezantohet si paraqitje e denjë dhe e sistemuar e lëndës etnografike [...] (Alb9)

B4 Segmenti: *Prezantimi i autorit / i veprave të mëparshme të autorit*

(12) Andre du Nay hatte seine bemerkenswerte Schaffenskraft zur Lösung dieses Rätsels der rumänischen Vor- und Frühgeschichte vor genau 19 Jahren unter Beweis gestellt. (Dt27)

‘Andre du Nay dëshmoi fuqinë e tij krijuese mbresëlënëse për zgjidhjen e kësaj enigme të historisë së hershme të Rumanisë, pikërisht para 19 vjetëve’

(13) Bahri Beci ist den Albanologen vor allem als Dialektologe und Phonetiker bekannt. (Dt20)

‘Bahri Beci njihet nga albanologët para së gjithash si dialektolog dhe fonetist’

Në segmentin B4 vihen re ngjashmëri të mëdha midis recensioneve në gjuhën gjermane dhe shqipe. E njëjta vlen edhe për segmentin B5:

B5 Segmenti: *Analiza e statusit të kërkimit / Klasifikimi i veprës*

(14) Cultural Memory ist heute zu einem internationalen Leitthema in Wissenschaft, Kunst und Gesellschaft geworden [...] (Dt10)

‘Cultural Memory është kthyer në ditët e sotme në një temë motiv në shkencë, art dhe shoqëri’

(15) Duke tematizuar koherencën e tekstit libri trajton probleme aktuale në fushën e lingvistikës. Në këtë libër trajtohen koherenca semantike si dhe koherenca komunikative e pragmatike. (Alb12)

Segmenti B5 informon lexuesin dhe e orienton atë, duke e renditur/klasifikuar veprën e recensuar në një kontekst të caktuar shkencor. Ky

segment ka një vlerë të ngjashme si në recensionet shqipe ashtu edhe ato gjermane.

B6 Segmenti: *Hyrje e përgjithshme në temë*

(16) Bekanntlich gibt es einen Bedarf an Lehr- und Arbeitsbüchern, die vor allem Studierende bzw. Studienanfänger in der Germanistik zum Lernen anregen und gleichzeitig in die Linguistik einführen. (Dt1)

‘Njihet fakti që ekziston një nevojë e madhe për metodat mësimore dhe librat e punës, të cilat para së gjithash nxisin studentët e gjermanistikës për të mësuar por njëkohësisht edhe për të përvetësuar njohuri në linguistikë’

(17) Trajtimi i materialit, e në mënyrë të veçantë futja e njohurive të reja merr në konsideratë njohuritë që nxënësit disponojnë si dhe objektivat përkatës të kurrikulës. (Alb4)

Segmentet e trajtuara deri tashmë B1-B6 paraqesin modele të njëjta zhvillimi të recensioneve shkencore në gjuhën shqipe dhe gjermane.

B7 Segmenti: *Paraqitje paraprake e vlerësimit*

(18) Dieser ausgesprochen anregende und sehr umfassende Beitrag bietet [...] (Dt29)

‘Ky artikull shumë tërheqës dhe shumë përmbledhës ofron [...]’

(19) Vepra në fjalë ban pjesë në fondin e artë të burimeve historike të dorës së parë që autori i paraqet kryesisht studiuesve të historisë sonë por edhe gjithë atyne që janë të dashnuem dhe dëshirojnë me njohtë ma mirë historinë. (Alb3)

Pas të dhënave bibliografike në recensionet gjermane paraqiten informacione hyrëse mbi publikimin. E njëjta gjë vërehet edhe tek recensionet në gjuhën shqipe, me ndryshimin që shumë recensione në gjuhën shqipe e vlerësojnë publikimin në mënyrë shumë ekspresive, siç e tregon edhe shembulli 19.

B8 Segmenti: *Analiza e grupit të adresuar*

(20) Das Buch ist eine Art Handreichung für Lehrende, die notwendige Erkenntnisse im Bereich DaZ, praktische Tipps, Unterrichtsvorschläge und Kopiervorlagen für den DaZ- Unterricht enthält. (Dt8)

‘Libri është një prospekt për mësuesit, i cili përmban njohuri nga fusha DaZ, të dhëna praktike, modele orësh mësimore,

(21) Teksti mësimor i autorëve Rexhep Cuko, Niko Kreci e Neritan Babamusta realizon në praktikë programin përkatës për klasën e dytë të të gjithë profileve të arsimit të mesëm të përgjithshëm. (A3)

C Pjesa e tekstit: *Pjesa kryesore*

C1 Segmenti: *riprodhimi i përmbajtjes së veprës/ përmbledhje e thënieve kryesore*

(22) In den ersten Kapiteln erklärt Adamcova Sprache und Sprechen als wissenschaftlich-empirische Objekte, fasst zahlreiche Definitionen von Sprache vom Standpunkt verschieden orientierter Sprachtheorien zusammen und bietet einen Überblick über die wichtigsten Sprachkonzeptionen. (Dt1)

‘Në kapitujt e parë Adamcova shpjegon gjuhën dhe aktin e të folurit si objekte empirike shkencore, ajo pëmbledh përcaktime të shumta mbi gjuhën nga këndvështrimi i teorive të ndryshme gjuhësore si dhe ofron një pamje të përgjithshme mbi konceptet më të rëndësishme gjuhësore.’

(23) Tematika e shkrimeve është e larmishme. Në to trajtohen probleme të historisë së përgjithshme të gjuhës shqipe ku përfshihen: Prejardhja e gjuhës shqipe [...], marrëdhëniet e shqipes me rumanishten, ndryshimet fonetike të vona të shqipes dhe rumanishtes, huazimet latine të gjuhës shqipe, emri i shqiptarëve [...] (Alb1)

Në recensionet në gjuhën gjermane shpesh përdoren edhe citime direkte (shembull 24) ose jepen udhëzime për literaturë plotësuese. Në recensionet në gjuhën shqipe gjenden shpesh herë udhëzime për literaturë plotësuese, por citimet direkte (si në shembullin 25) përdoren shumë rrallë.

(24) Er plädiert für eine Rückbesinnung auf die sprachlichen Grundlagen der Tätigkeit des Übersetzens, denn Sprachwissenschaft ist die Grundwissenschaft der Übersetzungswissenschaft. “Sprache ist in ihrer allgemeinen Form Manifestation der wichtigsten kognitiven und emotiven Anlagen des Menschen; sie ist andererseits, in ihrer konkreten historischen Form, d.h. als Einzelsprache, Kristallisation der Erfahrungen einer menschlichen Gemeinschaft.“ (Dt2)

‘Ai këmbëngul për një kthim tek bazat gjuhësore të përkthimit, pasi gjuhësia është shkenca bazë e disiplinës së përkthimit. “Gjuha është në formën e saj të përgjithshme një manifestim i aftësive të rëndësishme konjitive dhe emotive të njeriut; ajo është nga ana tjetër në formën e saj konkrete historike një kristalizim i përvojave të shoqërisë njerëzore”

(25) Nuk do të mungojnë në lidhje me këtë aspekt të përdorimit të shenjave grafike të caktuara përjashtimisht me autorët e tjerë të arealit kulturor të Veriut, sidomos në drejtim të përdorimit të disa shkronjave të cilat nuk janë të burimit latin dhe që ndeshen edhe në trajtimet ad hoc të kryera nga studiues si E. Çabej: “Paketës së shkronjave të alfabetit latin. italian i janë shtuar në sistem ashtu sikurse tek autorët e tjerë të arealit kulturor të Shqipërisë së Veriut, edhe një tufëz shkronjash me burim jolatin të cilat Bardhi i paraqet në pjesën hyrëse të fjalorit si: tres præcipuas ac fingulares haberent Epirotæ [...]” (Alb6)

C2 Segmenti: *vlerësimi i përmbajtjes*

C2a *vlerësim pozitiv*

(26) Deutsch mit Spaß und Spiel erfüllt die neuesten Standards der Fremdsprachendidaktik und -methodik und stellt gut funktionierende Arbeitsmaterialien zur Verfügung, die sich auch im DaF-Unterricht sehr flexibel einsetzen und adaptieren lassen. Das Buch integriert kommunikative, interkulturelle und handlungsorientierte Didaktik und Methodik, die überall spürbar sind. Mit diesem Buch hat man durchdachtes und gut funktionierendes Material zur Hand. (Dt8)

‘Libri “Gjermanishja përmes zbavitjes dhe lojës” plotëson standardet më të reja të didaktikës dhe metodikës së gjuhës së huaj dhe ofron materiale mësimore të cilat mund të adoptohen apo përdoren në mënyrë fleksible në orët mësimore. Libri integron didaktikën dhe metodikën komunikative, interkulturore dhe praktike. Ky libër është një material i mirë në dorën e mësuesit.’

(27) Në këtë botim dinjitoz, nxënësit do të gjejnë një këshillues të mirë, mësuesit një udhëheqës të mirë dhe prindërit një orientues të mirë. (Alb12)

Recensionet në gjuhën shqipe përmbajnë pothuajse pa përjashtim një vlerësim shumë pozitiv të veprës së publikuar. Recensuesit në përgjithësi vënë në pah anët pozitive të veprës, shumë rrallë shfaqen kritika.

C2b *vlerësim negativ*

(28) Neben dem bedauerlicherweise fehlenden Personen- sowie Sachregister lässt sich angesichts dieses insgesamt inspirierenden Ansatzes vor allem die übergroße Praxisferne kritisieren. Sehr sporadische, aber abstrakt bleibende Hinweise auf den DaF-Kontext sowie der knappe Hinweis auf der letzten Seite, dass ohne genaue Kenntnisse des allgemeinen Lernkontextes keine Verwendungsprinzipien genannt werden können, erscheinen zu wenig für eine Konzeption, die ihre Gegenstände gerade aus sich in der Praxis ergebenden Erkenntnisinteressen gewinnen möchte. (Dt4)

(29) Rrallëherë ndodh që një lexues i “Hyllit” të mos e ndjejë veten mirë, pasi ka lexuar një shkrim të botuar në faqet e revistës [...] Lejohem të citoj këtu shkrimin [...] që ka për autore zonjën [...], e cila krahas nismës më se të lëvdueshme për të njohur lexuesin e sotëm me tekstin origjinal të vendimeve të atij sinodi, rreket e rravgon sado përciptas nëpër studimet e mëhershme të filologëve e historianëve shqiptare [...] (Alb13)

Një vlerësim i qartë negativ si në shembullin 29 gjendet shume rrallë në recensionet në gjuhën shqipe, gjë që vihet re shpeshherë në recensionet në gjuhën gjermane.

C3 *Segmenti: Vlerësimi i formës/ i paraqitjes gjuhësore*

(30) Das hier zu besprechende Buch hat trotz seines relativ geringen Umfangs eine recht komplizierte Struktur. Es stellt eine Sammlung von Aufsätzen, Vorträgen, Diskussionsbeiträgen und Interviews zum Standartalanbischen dar [...]. (Dt20)

‘Libri që po diskutohet këtu pavarësisht një volumi jo shumë të madh ka një strukturë të komplikuar. Ai paraqet një përmbledhje esesh, kumtesash, artikujsh dhe intervistash në lidhje me gjuhën standarde shqipe [...]’

(31) Gjuha, stili i rrjedhshëm e literatura e pasur sigurojnë një komunikim më të lehtë. (Alb18)

C4 *Segmenti: Relativizimi i kritikës*

(32) Wer einen mutigen Schritt in Richtung der Schnittstelle zwischen Empirie und Didaktik erwartet, wird enttäuscht. Einen echten Spagat zwischen Didaktik und Empirie durch konkrete Schlussfolgerungen im Sinne

didaktisch-normativer Aussagen wagen die Verfasser nicht. Dennoch erscheint der Abschlussappell begründet [...]. (Dt33)

‘Çdokush që pret një hap të guximshëm në drejtim të gërshetimit të hulumtimeve empirike dhe didaktikës do të zhgënjehet. Një balancim të vërtetë midis didaktikës dhe studimeve empirike nëpërmjet konkluzioneve konkrete autorët e këtij botimi nuk e ndërmarrin. Megjithatë, apeli përfundimtar i këtij libri është i argumentuar.’

(33) [...] disa nga veprat e Rexhep Hoxhës, Rifat Kukajt autori nuk ka mundur t’i zbërthejë më hollësisht. Ndoshta në këtë fushë nuk ka studime të veçanta që mund ti vinin në ndihmë. (Alb10)

Analiza krahasuese e korpusit tregon se recensentët gjermanë kritikojnë në mënyrë më direkte krahasuar me recensentët shqiptarë. Ata shpeshherë vënë në pikëpyetje në mënyrë eksplicite rezultatet apo përfundimet e një studimi. Ndërkohë që recensuesit shqiptarë e shprehin kritikën e tyre në mënyrë jo të drejtpërdrejtë. Siç mund të vihet re në shembullin 33 shpesh ata justifikojnë mangësi të një vepre duke dhënë arsyet të cilat janë përgjegjëse për këto mangësi.

C5 Segmenti: *Propozime për përmirësime*

(34) Trotzdem sollte aber die empirische Forschung, manchmal wenigstens zum Zwecke der Hypothesengenerierung, fortgeführt werden. (Dt5)

‘Megjithatë kërkimi empirik duhet vazhduar, të paktën për gjenerimin e hipotezave.’

(35) Në këtë kuadër, me shkrimin e vet të titulluar “Modelet mbizotëruese sot, këndvështrime të ndryshme sipas traditave dhe evoluimit historik“ autorja [...] duhet të bënte më shumë përpjekje, për të ndriçuar më hollësisht disa nga modelet më “në zë“ të mësimdhënies. (Alb5)

Propozimet për përmirësime janë një mënyrë tjetër me anë të së cilës recensuesit shqiptarë i shmangen kritikës direkte. Një ridiskutim i rezultateve kyçe të kërkimit vlen në shoqërinë shqiptare dukshëm si jo oportun.

D Pjesa e tekstit: *Përfundimi*

D1 Segmenti: *Vlerësimi i përgjithshëm*

(36) Die Lektüre des Sammelbandes ist zur methodischen Orientierung daher unbedingt zu empfehlen. (Dt6)

‘Leximi i këtij vëllimi për një orientim metodik rekomandohet në mënyrë të padiskutueshme’

(37) Si përfundim, gjykoj se teksti i plotëson kriteret për tu cilësuar tekst mësimor bazë i lëndës së Sjelljes konsumatore. Së fundi duhet të theksoj se ky tekst është plotësisht në përputhje me programin mësimor përkatës. (Alb1)

Recensionet në gjuhën shqipe përmbajnë shpesh vlerësime të përgjithshme, të cilat vlerësojnë në mënyrë të përmbledhur përmbajtjet e një teksti ose rezultatet e një kërkimi. Recensuesit shqiptarë kanë tendencën të përmbledhin rezultatet pa i krahasuar ato me rezultate të mëparshme në të

njëjtën fushë. Ndërkohë që recensentët gjermane i japin më shumë rëndësi klasifikimit të veprës së recensuar në diskutimin akademik të kohës.

D2 Segmenti: *Paraqitja e anëve të forta/ të dobta*

(38) Die Nützlichkeit dieses Buches liegt auf der Hand, da Lerner hier ein komplexes Angebot von Begriffen, Methoden und Ergebnissen der deutschen Sprachwissenschaft bis zur deutschen Gegenwartsprache – und ihren früheren Sprachformen- vorfinden. (Dt1)

‘Dobia e këtij libri është e dukshme, pasi nxënësit këtu gjejnë një mori komplekse konceptesh, metodash dhe rezultatesh të gjuhësisë gjermane deri në stadin e sotëm, si dhe të formave të hershme gjuhësore’

(39) [...] Mjaft i pasur rezulton aparati pedagogjik i tekstit me pyetje, përgjigje, shtrim problemesh etj. [...] (Alb4)

Në kundërshtim me recensionet në gjuhën gjermane, recensionet në gjuhën shqipe theksojnë anët e forta të një vepre.

D3 Segmenti: *Rekomandimi për t'u lexuar*

(40) Leider bleibt der didaktische Blickwinkel dieser Abhandlung ausschließlich auf die Vorbereitungsfunktion der Schule auf das wissenschaftliche Schreiben gerichtet, was KRUSE jedoch selbst in seinen abschließenden Schlussfolgerungen anführt. Berufliches, künstlerisches und journalistisches Schreiben sind gleichermaßen Bezugsgrößen, die weitere Überlegungen lohnenswert erscheinen lassen. Fazit: Lesenswert! (Dt32)

Për fat të keq këndvështrimi didaktik i këtij trajtimi mbetet vetëm në funksionin përgatitor të shkollës për shkrimin shkencor, gjë që e vë në pah edhe KRUSE në konkluzionet përmbyllëse. Shkrimi profesional, artistik dhe gazetaresk janë po kaq të rëndësishme dhe për këtë ja vlen të konkludohet. Përfundimi: Ia vlen të lexohet!

(41) [...] libri i këtij autori rekomandohet për studiuesit e ardhshëm, të cilët dëshirojnë të merren me studime krahasimtare [...] (Alb10)

D4 Segmenti: *Kontributi për kërkimet në të ardhmen*

(42) Zusammenfassend bleibt jedoch festzuhalten, dass der Band eine facettenreiche Synopse aktueller Forschung im Bereich des Zweitsprachenerwerbs bietet. (Dt32)


‘Në mënyrë të përmbledhur mund të theksojmë se vëllimi ofron një sinopsë shumëdimensionale të kërkimit shkencor aktual në fushën e përvetësimit të një gjuhe të dytë’

(43) Ky botim sjell impulse të reja për shkencëtarët e rinj në fushën e dialektologjisë. (Alb40)

Klasifikimi i veprës së recensuar në kontekstin shkencor, vlerësimi i rezultateve të kërkimit si dhe rekomandimet për lexuesin janë pika standarde të recensioneve shqiptare dhe gjermane.

2.3 Pjesë të teksteve dhe segmente të recensioneve shkencore në gjuhën shqipe dhe gjermane: Të përbashkëtat dhe ndryshimet kulturore.

Analiza na lejon të vëmë re në recensionet në gjuhën shqipe dhe gjermane tendenca të caktuara të cilat na bëjnë të qartë ndikimin kulturor tek ky lloj teksti. Shpeshtësia e segmenteve të caktuara (tab. 1) tregon se midis dy gjuhëve ka shumë ngjashmëri. Së pari, të gjitha segmentet tekstore dëshmojnë në korpuset e krahasuara. Karakteristikave jo variable d.m.th. pjesëve obligatore të një recensionit i përketin në të dyja gjuhët përmbajtja e veprës (publikimit) si dhe format e ndryshme të vlerësimit duke përfshirë si vlerësimet e pjesshme ashtu edhe atë të përgjithshëm. Së dyti konstatohet se recensionet në gjuhën gjermane dhe shqipe ndjekin plane të njëjta ndërtimi tekstesh.



Tab. 1: Shpeshtësia e segmenteve në recensionet në gjuhën shqipe dhe gjermane

Krahas të përbashkëtave konstatohen edhe shumë ndryshime. Në recensionet në gjuhën gjermane një pjesë e madhe i kushtohet vlerësimit. Ndërkohë që veçanërisht në gjuhën shqipe më shumë rëndësi i jepet dhënies së përmbajtjes. Shumë rrallë konstatohet në recensionet në gjuhën shqipe një ballafaqim kritik i veprës së recensuar. Vlerësime eksplicit negative në përgjithësi shmangen. Recensuesit shqiptarë synojnë të paraqesin anët e forta të veprës. Ata japin shpesh arsyet për mangësitë e mundshme ose paraqesin propozime për përmirësime duke iu shmangur kritikës direkte.

3. Realizimi gjuhësor i kritikës

Pasi u konstatua se midis mënyrave të ndërtimit të teksteve të recensioneve dominojnë ngjashmëritë, duket me vend këtu edhe trajtimi i çështjes nëse ekzistojnë ndryshime kulturore në realizimin gjuhësor të kritikës në recensionet shkencore.

Në lidhje me këtë çështje u analizua në korpusin e përzgjedhur nëse kritika paraqitet relativizuese apo e përforcuar. Natyrisht që kritika manifestohet në forma të ndryshme dhe me mjete të shumta gjuhësore (me anë të mbiemrave, ndajfoljeve të mënyrës, shprehjeve ironike, metaforave dhe krahasimeve etj.)⁷ të cilat jo të gjitha mund të trajtohen në këtë artikull.

3.1 Relativizimi i kritikës nëpërmjet shprehjeve të vagëta (indirekte) (eng. hedges)

Emërtimi *hedges* është përmendur për herë të parë në një artikull të Lakoff (1972)⁸. Nën këtë koncept përfshihen në radhë të parë fjalë dhe shprehje, të cilat shërbejnë për të përforcuar ose relativizuar kritikën direkte.

Shprehje të tilla realizohen me anë të foljeve modale, ndajfoljeve të mënyrës, pjesëzave ose nëpërmjet përdorimit të përemrave, konstruksioneve në pësore madje edhe nëpërmjet figurave retorike.

Sipas Makkanen / Schröder⁹ shprehje të tilla shërbejnë për të modifikuar shkallën e së vërtetës apo për të theksuar rëndësinë e qëndrimit të autorit.

Funksioni primar i shprehjeve indirekte në tekstet e recensioneve është shprehja e një pasigurie në lidhje me saktësinë e një thënie, ose për të relativizuar apo për të minimizuar kritikën direkte ndaj tjetrit.

Përdorimi i këtyre shprehjeve mund të ndryshojë nga një kulturë në tjetrën. Kështu p.sh. Clyne përmend faktin se tek recensuesit gjermanë vihet re tendenca për të përdorur foljet modale, format në pësore të cilat i lejojnë atyre “të fshihen” pas thënieve ose të shprehen me kujdes për të mos e “diskriminuar” tjetrin.¹⁰

Një analizë kontrastive në lidhje me përdorimin e shprehjeve të vagëta në recensionet shqip dhe gjermanisht do të nxirrte në pah më shumë ndryshime se sa të përbashkëta. Ky supozim përbën edhe hipotezën për trajtimin e mëtejshëm:

Shprehje të cilat shërbejnë për të relativizuar kritikën janë si më poshtë:

-Pjesëzat përfruese si *rreth*, *përafërsisht*, *gati*, *thuajse*, (në gjermanisht: *ungefähr*, *ca.*, *einige*) për të anashkaluar thënie direkte

⁷ Dallman, 1979, 70 f.

⁸ Lakoff, 1972, f. 64.

⁹ Makkanen/ Schröder, 1997, f. 5.

¹⁰ Clyne, 1991, f. 380.

Realizimi gjuhësor i kritikës në recensionet shkencore. Vështrim krahasues...

-ndajfoljet e shpeshtësisë si *shpesh, ndonjëherë, rrallë, rastësisht, herë pas here* (në gjermanisht: *oft, gelegentlich, manchmal*)

-pjesëzat dyshuese apo shprehjet si: *gjë, kushedi, mbase, vallë, sikur, ndoshta, mundësisht, eventualisht, në kushte të caktuara, mjaftueshëm*, (në gjermanisht: *eventuell, unter Umständen, ziemlich, vermutlich, möglicherweise, eigentlich, wohl*)

Këto shprehje nuk e specifikojnë saktë gradën e mendimit të shprehur, por ja lënë në dorë recipientit të përcaktojë vetë masën e kuptimit.

Për qëllimet e kësaj analize dhe për shkak të krahasimit dhe qartësisë kemi zgjedhur vetëm ato ndajfolje modale, pjesëza dhe shprehje të cilat shërbejnë për të relativizuar kritikën.

Shembuj: *Etwas zu kurz kommen dabei allerdings ...*
[Gjithsesi ato janë trajtuar *paksa* shkurtimisht...]
Hier konstatiert der Leser *nicht ohne Bedauern*, dass....
[*Jo pa keqardhje* këtu lexuesi konstaton se...]
Vielleicht hat der Autor hier überreagiert ...
[Këtu autori *ndoshta* ka mbireaguar...]
Tematika është trajtuar *thujse*
Herë pas here autori rreket të na sjellë....
Ndoshta ky trajtim do t'i kalonte caqet...

3.2 Theksimi i kritikës nëpërmjet pjesëzave (shprehjeve) përforcuese

Krahas shprehjeve të vagëta (indirekte), të cilat shërbejnë për relativizimin e kritikës identifikojmë edhe pjesëzat e ndajfoljet, të cilat e përforcojnë më shumë kritikën. Të tilla janë në gjermanisht *sehr, besonders, außerordentlich, höchst* dhe në shqip *veçanërisht, shumë, jashtëzakonisht, madje, sidomos* etj. Në tekstet e recensioneve ato shërbejnë për të forcuar si gjykime pozitive ashtu edhe negative.

Shembuj: *Besonders krass* tritt diese Schwäche...
[Veçanërisht shumë rëndshëm dallohet kjo anë e dobët...]
Das Buch ist *wahrlich* keine bequeme Lektüre...
[Libri me të vërtetë nuk afron një përmbajtje të këndshme...]
Kjo shënon një arritje *me të vërtetë*...
Ky fakton kërkon *shumë më shumë* tregues...

Në korpusin e recensioneve të përzgjedhura u konstatua se recensuesit gjermanë të cilët përpiqen më shumë të kenë një stil konfrontues, përdorim më pak *hedges* (shprehje indirekte) se sa recensuesit shqiptarë.

Ndërsa përdorimi i pjesëzave përforcuese është më i lartë tek recensuesit gjermanë. Në shumicën e rasteve ato nënvizojnë (theksojnë) karakterin konfrontues me përmbajtjen.

4. Vetëpërmendja e autorit (perspektiva e paraqitjes)

Një tjetër fenomen me interes nga vështrimi ndërkulturor është perspektiva e paraqitjes së prodhuesit të tekstit, e cila manifestohet p.sh. nëpërmjet vetëpërmendjes së autorit. Kussmaul (1978)¹¹ në një analizë ndërgjuhësore arriti të vërtetonte se recensuesit gjermanë e përmendin shumë pak vetveten. Ky rezultat mund të shpjegohet me ekzistencën e konvencioneve të ndryshme të komunikimit dhe të traditave të ndryshme të shkruarit, të cilat bazohen mbi opinionin mbizotërues në rrethet shkencore gjermanishtfolëse që shprehja e mendimeve personale i kundërvihet efektit të dëshiruar të objektivitetit, neutralitetit dhe karakterit shkencor në përgjithësi.

Në korpusin e lartpërmendur vihet re se në recensionet shqiptare haset një numër më i madh përemrash vetorë (*të vetës së parë njëjës dhe shumës*) se në recensionet shkencore gjermane. Meqenëse tek recensionet kemi të bëjmë me një lloj teksti të formuluar në mënyrë shumë personale, ku nga ana e recipientëve nënkuptohet një masë e madhe subjektiviteti, mund të supozohet në përgjithësi që aty, në krahasim me tekste të tjera, merret shpesh në përdorim veta e parë. Kështu Gläser¹² i sheh përemrat në vetën e parë si "veçori" të recensioneve.

Recensione në gjuhën shqipe	Numri vetëpërmendjes (<i>unë, ne</i>)	i Shpeshtësia mesatare në çdo tekst
45	26	1,73

Recensione në gjuhën gjermane	Numri vetëpërmendjes (<i>unë, ne</i>)	i Shpeshtësia mesatare në çdo tekst
45	11	0,87

Në përgjithësi vetëpërmendjet e autorit shfaqen në tekstet shqipe pothuajse dy herë më shumë. Shumica dërrmuese e recensentëve mundohet ta evitojnë vetën parë, për ta paraqitur kritikën sa më objektive. Në vend të kësaj, u kthehen formave pësore ose edhe formulimeve pavetore. Recensentët gjermanë i shmangen vetëpërmendjes pjesërisht edhe duke u fshehur pas formulimit *der Leser* 'lexuesi', p.sh. *der Leser frat sich, ob* 'tek lexuesi lind pyetja nëse', *der Leser kann schwerlich nachvollziehen* 'lexuesi e ka të vështirë të kuptojë'. Tabela në vijim do të paraqesë disa shembuj nga korpusi, të cilët

¹¹ Kussmaul, 1978, f. 31.

¹² Gläser, 1990, f. 111.

Realizimi gjuhësor i kritikës në recensionet shkencore. Vështrim krahasues...

tregojnë se në gjuhën shqipe formulimet personale janë më fort të përdorura, kurse në gjermanisht preferohen formulimet jopersonale.

Shprehjet personale përkundrejt shprehjeve jopersonale

Recensionet shqip

Recensionet gjermanisht

1. Unë e rekomandoj pa dyshim këtë libër.	1. insofern ist das vorliegende Manual (...) ein wichtiges anzuempfehlendes Buch [ky manual meriton rekomandimet më të larta]
2. Fillimisht, më lejoni të komentoj ...	2. dazu sei kritisch angemerkt ... [Do të shënohej në mënyrë kritike...]
3. Na duket e vështirë të diskutojmë...	3. während der Lektüre mag sich der Leser zuweilen fragen, ob ... [Gjatë leximit lexuesi mund të pyesë...]
4. Ne po e përmbledhim shkurtimisht...:	4. Um mit den Autoren zu schließen: [Për të përfunduar me autorët...]

5. Përfundime

1. Recensionit shkencor si një formë specifike e komunikimit shkencor nuk realizohet i izoluar por gjithmonë në një kontekst sociokulturor të një shoqërie të caktuar gjuhësore.

2. Në gjuhën shqipe vihet re theksimi i anëve pozitive të veprës së recensuar. Në recensionet në gjuhën shqipe mbizotërojnë vlerësimet pozitive, ndërkohë që shprehja e mendimeve të kundërta luan një rol dytësor dhe është shumë e kufizuar. Në gjuhën shqipe nuk gjenden në përgjithësi vlerësime kategorike negative. Recensuesit shqiptarë i shmangen konfliktit ndërkohë që recensuesit gjermanë preferojnë kritikën. Kultura gjermane e debatit shkencor përfshin edhe mendimet ndryshe.

3. Edhe në lidhje me formën ka ndryshime të dukshme: Ndërkohë që një recensues gjerman në mënyrë individuale dhe shumë të vetëdijshëm analizon formën dhe përmbajtjen e veprës, recensuesi shqiptar orientohet në përgjithësi ndaj një modeli të dhënë recensimi.

4. Nga ky shqyrtim del që nëpër recensionet shfaqen dallime në nivelin ndërgjuhësor, veçanërisht për sa i përket mënyrës se si paraqitet kritika. Më fort spikaten diferencat për sa i përket mënyrës se si realizohet kritika nga ana gjuhësore. Ajo paraqitet në recensionet gjermane në mënyrë më direkte dhe zbutet më rrallë me pjesëza modale relativuese etj. Gjithashtu ajo formulohet në mënyrë jopersonale për ta paraqitur kritikën sa më objektive.

Literaturë

Korpusi:

- Dt1: Info DaF, Bd. 33 (2006), S. 130-132.
Dt2: Info DaF, Bd. 33 (2006), S. 132-134.
Dt3: Info DaF, Bd. 33 (2006), S. 134-135.
Dt4: Info DaF, Bd. 33 (2006), S. 136-138.
Dt5: Info DaF, Bd. 33 (2006), S. 138-139.
Dt6: Info DaF, Bd. 33 (2006), S. 144-146.
Dt7: Info DaF, Bd. 33 (2006), S. 146-147.
Dt8: Info DaF, Bd. 33 (2006), S. 154-155.
Dt9: Info DaF, Bd. 33 (2006), S. 162-163.
Dt10: Info DaF, Bd. 33 (2006), S. 164-165.
Dt11: Info DaF, Bd. 33 (2006), S. 165-168.
Dt12: Info DaF, Bd. 33 (2006), S. 169-171.
Dt13: Info DaF, Bd. 34 (2007), S. 295-297.
Dt14: Info DaF, Bd. 34 (2007), S. 297-300.
Dt15: Info DaF, Bd. 34 (2007), S. 300-302.
Dt16: Info DaF, Bd. 34 (2007), S. 302-304.
Dt17: Info DaF, Bd. 34 (2007), S. 304-306.
Dt18: Info DaF, Bd. 34 (2007), S. 306-307.
Dt19: Info DaF, Bd. 34 (2007), S. 308-310.
Dt20: Info DaF, Bd. 34 (2007), S. 310-313.
Dt21: Info DaF, Bd. 32 (2005), S. 112-116.
Dt22: Info DaF, Bd. 32 (2005), S. 121-122.
Dt23: Info DaF, Bd. 32 (2005), S. 138-141.
Dt24: Info DaF, Bd. 32. (2005), S. 161-164.
Dt25: Info DaF, Bd. 32. (2005), S. 176-178.
Dt26: Info DaF, Bd. 32. (2005), S. 195-199.
Dt27: Hylli i drites, Votër kulturore shqiptare 4, 2007 Shkodër.
Dt28: Info DaF, Bd. 34 (2007), S. 295-297.
Dt29: Info DaF, Bd. 34 (2007), S. 295-297.
Dt30: Deutsch als Fremdsprache (2) 2009, S. 119f.
Dt31: Deutsch als Fremdsprache (2) 2009, S. 121f.
Dt32: Deutsch als Fremdsprache (2) 2009, S. 122
Dt33: Deutsch als Fremdsprache (2) 2009, S. 124.
Dt34: Deutsch als Fremdsprache (2) 2009, S. 125.
Dt35: Info DaF, Bd. 35 (2008), S. 242-244.
Dt36: Info DaF, Bd. 35 (2008), S. 244-246.
Dt37: Info DaF, Bd. 35 (2008), S. 248-251.
Dt38: Info DaF, Bd. 35 (2008), S. 251-254.
Dt39: Info DaF, Bd. 35 (2008), S. 254-256.
Dt40: Info DaF, Bd. 35 (2008), S. 256-259.
Dt41: Info DaF, Bd. 35 (2008), S. 259-261.
Dt42: Info DaF, Bd. 35 (2008), S. 261-263.

Realizimi gjuhësor i kritikës në recensionet shkencore. Vështrim krahasues...

- Dt43: Info DaF, Bd. 35 (2008), S. 263-265.
Dt44: Info DaF, Bd. 35 (2008), S. 265-267.
Dt45: Info DaF, Bd. 35 (2008), S. 267-269
- Alb1: Studime 3 1997, Prishtinë, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, F. 346-348.
Alb2: Hylli i dritës, 2, 2008, Shkodër, F. 139
Alb3: Gjurmime albanologjike, Seria e Shkencave Historike, 18, Prishtinë 1989, F. 240.
Alb4: Gjurmime albanologjike, Seria e Shkencave Historike, 18, Prishtinë 1989, F. 243.
Alb5: Gjurmime albanologjike, Seria e Shkencave Historike, 18, Prishtinë 1989, F. 245.
Al 6: Gjurmime albanologjike, Seria e Shkencave Historike, 18, Prishtinë 1989, F. 246.
Alb7: Hylli i dritës, Votër kulturore shqiptare 4, 2007 Shkodër.
Alb8: Gjurmime albanologjike, Seria e Shkencave Historike, 18, Prishtinë 1998, F. 247.
Alb9: Gjurmime albanologjike, Seria e Shkencave Historike, 18, Prishtinë 1989, F. 250.
Alb10: Gjurmime albanologjike, Seria e Shkencave Historike, 18, Prishtinë 1989, F. 253.
Alb11: Studime 3, 1997, Prishtinë, Akademia e shkencave dhe arteve e Kosovës, F. 335.
Alb12: Studime 3, 1997, Prishtinë, Akademia e shkencave dhe arteve e Kosovës, F. 337.
Alb13: Studime 3, 1997, Prishtinë, Akademia e shkencave dhe arteve e Kosovës, F. 343.
Alb14: Studime 3, 1997, Prishtinë, Akademia e shkencave dhe arteve e Kosovës, F. 346.
Alb15: Studime Filologjike, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2004, nr. 7 Tiranë, F. 187.
Alb16: Studime 3, 1997, Prishtinë, Akademia e shkencave dhe arteve e Kosovës, F. 348.
Alb17: Studime 3, 1997, Prishtinë, Akademia e shkencave dhe arteve e Kosovës, F. 351.
Alb18: Studime 3, 1997, Prishtinë, Akademia e shkencave dhe arteve e Kosovës, F. 353.
Alb19: Studime 3, 1997, Prishtinë, Akademia e shkencave dhe arteve e Kosovës, F. 355.
Alb20: Studime 3, 1997, Prishtinë, Akademia e shkencave dhe arteve e Kosovës, F. 357.
Alb21: Studime Filologjike, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2004, nr. 7 Tiranë, F. 177.
Alb22: Studime Filologjike, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2004, nr. 7 Tiranë, F. 188.
Alb23: Studime Filologjike, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2004, nr. 7 Tiranë, F. 191.
Alb24: Gjurmime albanologjike, Seria e Shkencave Historike, 18, Prishtinë 1989, F. 256.
Alb25: Gjurmime albanologjike, Seria e Shkencave Historike, 18, Prishtinë 1989, F. 263.
Alb26: Gjurmime albanologjike, Seria e Shkencave Historike, 18, Prishtinë 1989, F. 265.
Alb27: Gjurmime albanologjike, Seria e Shkencave Historike, 18, Prishtinë 1989, F. 267.
Alb28: Studime historike, Tiranë 2002, Instituti i Historisë, F. 201.
Alb29: Studime historike, Tiranë 2002, Instituti i Historisë, F. 205.
Alb30: Studime historike, Tiranë 2002, Instituti i Historisë, F. 209.
Alb31: Hylli i dritës, Votër kulturore shqiptare 4, 2007 Shkodër, F. 241.
Alb32: Hylli i dritës, Votër kulturore shqiptare 4, 2007 Shkodër, F. 246.
Alb33: Hylli i dritës, Votër kulturore shqiptare 4, 2007 Shkodër, F. 248.
Alb34: Hylli i dritës, Votër kulturore shqiptare 4, 2007 Shkodër, F. 250.
Alb35: Hylli i dritës, 3, 2008 Shkodër, F. 208.
Alb36: Hylli i dritës, 3, 2008 Shkodër, F. 212.
Alb37: Hylli i dritës, 1, 2009 Shkodër, F. 187.

- Alb38: Studime historike, Tiranë 2003, Instituti i Historisë (3-4), F. 175.
Alb39: Studime historike, Tiranë 2002, Instituti i Historisë, F. 183.
Alb40: Studime historike, Tiranë 2002, Instituti i Historisë, F. 187.
Alb41: Studime historike, Tiranë 2002, Instituti i Historisë, F. 191.
Alb42: Studime historike, Tiranë 2003, Instituti i Historisë, F. 221.
Alb43: Studime historike, Tiranë 2003, Instituti i Historisë, F. 227.
Alb44: Studime historike, Tiranë 2003, Instituti i Historisë, F. 231.
Alb45: Studime historike, Tiranë 2003, Instituti i Historisë, F. 237

LITERATURA SEKONDARE

- Dallmann, Sabine (1979): "Die Rezension. Zur Charakterisierung von Texttyp, Darstellungsart und Stil". Në: Linguistische Studien. Reihe A/51. Berlin.
- Clyne, Michael (1991): "Zu kulturellen Unterschieden in der Produktion und Wahrnehmung englischer und deutscher wissenschaftlicher Texte". Në: Info DaF 18-4
- Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë 1984. Akademia e shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i letërsisë. kolona 1012.
- Gläser, Rosemarie (1990): Fachtextsorten im Englischen. Tübingen
- Hutz, Matthias (2001): Insgesamt muss ich zu einem ungünstigen Urteil kommen. Zur Kulturspezifik wissenschaftlicher Rezensionen im Deutschen und Englischen. Në: Fix, Ulla/Habscheid, Stephan/Klein, Josef (Hrsg.): Zur Kulturspezifik von Textsorten. Tübingen, S. 109-127.
- Kussmaul, Paul (1978): "Kommunikationskonventionen in Textsorten am Beispiel deutscher und englischer geisteswissenschaftlicher Abhandlungen". Në: Lebende Sprachen 23.
- Lakoff, George (1972): "Hedges: A Study of Meaning Criteria and the Logic of Fuzzy Concepts". Në: P. Peranteu et al: Papers from the Eighth Regional Meeting of Chicago Linguistic Society. Chicago.
- Liang, Yong (1991): Zu soziokulturellen und textstrukturellen Besonderheiten wissenschaftlicher Rezensionen: Eine kontrastive Fachtextanalyse Deutsch/Chinesisch. Në: Deutsche Sprache, Heft 19, S. 289-311.
- Markkanen, Raija/ Hartmut Schröder (1997): "Hedging: A challenge for Pragmatics and Discourse Analysis. Berlin/ New York.
- Oldenburg, Hermann (1992) Angewandte Fachtextlinguistik. "Conclusions" und Zusammenfassungen. Tübingen.
- Wiegand, Herbert Ernst (1983): Nachdenken über wissenschaftliche Rezensionen. Anregungen zur linguistischen Erforschung einer wenig erforschten Textsorte. In: Deutsche Sprache, Heft 11, S. 122- 137.